



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY
Nr.i Prot./Br. Prot./Prot.No. 80/23-02/10
Nr.i Fq./Br. St./No.Pg. 13
Data/Datum/Date: 24.02.2023
DOK. ZYRË DILSHAD DHE TIKJA

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës

Autoritet za Konkurenciju Republike Kosovo - Competition Authority of the Republic of Kosovo



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

Nr. 23/2023
Datë 24.02.2023

Në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 35, nenit 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056 (Gazeta zyrtare Nr. 14/2022), bazuar në iniciativën e Nota Brillant Official Sh.P.K kundër Nota Brillant (Design & Style) SH.P.K, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datën 24.02.2023 merr këtë:

K O N K L U Z I O N

Me të cilën konkludon se Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, nuk është kompetent për të shqyrta ankesën sipas Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, sipas nenit 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6.

A r s y e t i m

Iniciativa për fillimin e procedurës:

Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës, më datë 09.08.2022 ka pranuar një ankesë nga kompania Nota Brillant Official SH.P.K., kundër Nota Brillant (Design & Style) SH.P.K., lidhur me pretendimet për përdorimin e emrit dhe shenjës së biznesit “Nota Brillant Official SH.P.K.”, e po ashtu gjatë gjithë kohës përmes reklamave, shenjave treguese në magjistralen Ferizaj – Prishtinë (ku konsumatorëve ju thotë se qendra kryesore gjendet pak kilometra larg asaj të palës së dëmtuar).

Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 30, neni 35 par. 1, neni 39, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka autorizuar grupin e punës, të siguroj të dhënat e nevojshme për shqyrtimin paraprak lidhur me rastin në fjalë.

Pretendimet e palës ankuese:

Pala ankuese pretendon se është duke i'u shkelur marka dhe emri tregtar “Nota” e cila është në emër të z. Faton Sylejmani duke i shkaktuar kështu humbje të mëdha atij dhe firmës së tij. Nota Brillant Design & Style SH.P.K., ka shkaktuar dhe vazhdon të shkaktoj konfuzion tek klientët duke u paraqitur si pronar i markës NOTA, paraqet reklama para biznesit original të NOTA duke thënë se pika kryesore e këtij biznesi është rreth 4 km prej pikës së biznesit original. Në këtë formë

biznesi original i pronarit z. Faton Sylejmani i cili edhe e ka të regjistruar markën tregtare Nota është duke pësuar dëme të mëdha financiare.

Më dt. 15.04.2022 pala ankuese ka parashtruar po ashtu padi-propozim për vendosje të masës së përkohshme ndaj biznesit kopjues por që deri më tanë nuk është ndërmarr asnjë veprim nga ana e Gjykatës për këtë çështje.

Listë e produkteve dhe shërbimeve (Nota) - Regjistrimi i markës Tregtare:

Klaza 24: Pëlhura të endura dhe mallra tekstili që nuk përfshihen në klasa të tjera, mbulesa për shtretër dhe tavolina, materiale tekstili, perde dushi prej tekstili, perde prej tekstili, pëlhura për amvisri, pëlhir tavoline etj.

Klaza 27: Qilima, rrogoz këmbësh, tapiceri, mbulesa të tjera për dysheme nga goma.

Klaza 35: Reklamim, udhëheqje më punë, menaxhim me punën, punë zyrash, prezantim i prodhimeve, shitje me shumicë dhe pakicë, import-eksport.

Vlerësimi i konkurrencës:

Mandati i Autoritetit të Konkurrencës (AKRK), që rrjedhë nga zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës është: identifikimi dhe vlerësimi i marrëveshjeve të ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve dhe përcaktimin e masave, kushteve dhe afateve për eliminimin e efekteve të dëmshme të marrëveshjeve të ndaluara, përcaktimin e keqpërdorimit të pozitës dominuese të ndërmarrjeve dhe ndalimin e çdo sjelljeje të mëtejshme që çon në abuzim dhe përcaktimin e masave, kushteve dhe afateve për eliminimin e efekteve të dëmshme të një sjelljeje të tillë, dhe vlerësimi ex ante i ndërmarrjeve në proces të përqendrimeve, të gjitha në bazë të analizave të hollësishme ligjore dhe ekonomike sipas procedurave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Dëshirojmë të theksojmë se AKRK-ja kryen detyrat e një agjencie të pavarur, kombëtar, përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës në të gjitha tregjet ekskluzivisht brenda fushëveprimit dhe kompetencave të përcaktuara nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës nuk është kompetent për zbatimin e ligjeve të veçanta, por aspekti ligjor dhe rregullator, është në kompetencë të rregullatorëve të tjerë sektorialë, e në këtë rast Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë konkretisht “Agjencia për pronësi Industriale”, e cila përmes Ligjit Nr. 08/L-075 për markat tregtare, e ushtron të drejtën si autoritet juridik publik, përgjegjëse për regjistrim, mbikëqyrjen, dhe zbatimin e këtyre të drejtave.

Markë tregtare mund të jetë çdo shenjë, në veçanti fjalët, duke përfshirë emrat personal ose vizatimet, shkronjat, numrat, ngjyrat, formën e mallrave ose të paketimeve të tyre ose tingujtzërat, me kusht që këto shenja mund:

- 1.1. të dallojnë mallrat apo shërbimet e një subjekti ekonomik nga subjekti tjetër ekonomik;
- 1.2. të përfaqësohen në regjistër në mënyrë të tillë, që të iu mundësojnë autoriteteve kompetente dhe publikut të përcaktojnë qartë dhe saktë objektin e mbrojtjes që i njihet pronarit të saj.

Pra mandati i AKRK-së nuk është mbrojtja e markës tregtare dhe këtë fushë e rregullon Ligji Nr. 08/L-075 për markat tregtare. Me këtë ligj përcaktohen kushtet dhe procedurat për regjistrimin e markave tregtare, të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave.

Për nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Komisioni

Neime Binaku - Isufi

Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkyetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çëshjje administrative.

Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- *Pala ankuese*
- *Publikohet në web faqen e Autoritetit*
- *Arhiva*